



NJOFTIM PËR MEDIA

Ditën e premte, në datën 04 dhjetor 2020, në mjediset e Autoritetit të Mediave Audiovizive (AMA) u zhvillua mbledhja e radhës së AMA-s, ku morën pjesë anëtarët e mëposhtëm:

Gentian	SALA	Kryetar
Sami	NEZAJ	Zëvendëskryetar
Agron	GJEKMARKAJ	Anëtar
Gledis	GJIPALI	Anëtar
Suela	MUSTA	Anëtar

AMA, pasi shqyrtoi çështjet e rendit të ditës, vendosi:

1. Pranimin e aplikimit të shoqërisë “ABEG” sh.p.k., dhe dhënien e licencës për ofrimin e shërbimit të programit audioviziv të përgjithshëm “TV ABEG” në qarqet Tiranë dhe Durrës. **(Vendimi nr. 132, datë 04.12.2020)**
2. Përcaktimin e frekuencave për shërbimin e transmetimit audio analoge dhe çeljen e garës për dhënien e licencës të transmetimit audio analoge në Bashkitë Elbasan, Cërrik dhe Belsh. **(Vendimi nr. 133, datë 04.12.2020)**
3. Zëvendësimin e licencës për transmetime analoge me licencë shërbimi programi audioviziv të shoqërisë “Media Motiv” sh.a.” për subjektin audioviziv “Tv Channel 1”, për të ofruar shërbim në qarkun Shkodër. **(Vendimi nr. 134, datë 04.12.2020)**
4. Rinovimin e licencës së shoqërisë “Antena” sh.p.k., për subjektin audio privat “Radio Love 90.7” **(Vendimi nr. 135, datë 04.12.2020)**
5. Rinovimin e licencës së shoqërisë “Top Gold” sh.p.k., për subjektin audio privat “Radio Top Gold”. **(Vendimi nr. 136, datë 04.12.2020)**
6. Rinovimin e autorizimit të shoqërisë “ABCCom” sh.p.k., për ofrimin e shërbimit të programit audioviziv mbështetur në rrjet kabllor “3N1 TV”. **(Vendimi nr. 137, datë 04.12.2020)**
7. Rinovimin e autorizimit të shoqërisë “Bleta” sh.p.k., për përsëritjen e shërbimit të programit audioviziv të të tretëve, online mbështetur në rrjet IP (IPTV) “Bleta”. **(Vendimi nr. 138, datë 04.12.2020)**
8. Rinovimin e autorizimit të subjektit person fizik Dorina Marini, për përsëritjen e shërbimit të programit audioviziv të të tretëve mbështetur në rrjet kabllor “Tv kabllor Andor”. **(Vendimi nr. 139, datë 04.12.2020)**

AMA në këtë mbledhje mori në shqyrtim çështjen e vlefshmërisë së licencës së shoqërisë “Intel Media” sh.p.k., për subjektin audio privat “Radio Jug” dhe ra dakord t’i caktojë këtij subjekti afat deri në mbledhjen e radhës për përmbushjen e detyrimeve ndaj AMA-s.

AUTORITETI I MEDIAVE AUDIOVIZIVE

Tiranë, më 04 dhjetor 2020